



VENDIM

Nr. 3, Datë 14/07/2016

MBI

KRITERET KRYESORE DHE TARIFAT E REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PJESËMARRËS NË KONKURSET E PRANIMIT DHE NË REGJISTRIMIN E TYRE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE PËR VITIN AKADEMIK 2016-2017

Në zbatim të, pika 28, 29, neni 6, (Përkufizime), neni 74 (Pranimi në ciklin e parë të studimeve), neni 38 - të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", projekt-buxhetit vjetor të vitit 2017,

VENDOSI

1. Pikët maksimale për konkurrim në një nga programet e studimit në fakultetet e Universitetit të Arteve janë 140 pikë, me këtë ndarje
 - a. 30 % e pikëve (*nota mesatare e viteve të shkollimit dhe provimet e Maturës Shtetërore*), sipas tabelës bashkëngjitur;
 - b. 70 % e pikëve (Rezultatet e konkursit të pranimi);
2. Kufiri minimal i pranimi të konkurrentëve të jetë: 60 pikë.
3. "Tarifa e regjistrimit të kandidatëve pjesëmarrës në konkurset e pranimi", është 5 000 (pesë mijë) lekë dhe paguhet në sistemin bankar ose në filialet e Postës Shqiptare.
4. "Tarifa e regjistrimit" për një program studimi në fakultetet e Universitetit të Arteve është 1 600 (njëmijë e gjashtëqind) lekë dhe paguhet në sistemin bankar ose në filialet e Postës Shqiptare.
5. Vendim të publikohet në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Asoc. Vladimir MYRTEZAI (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Asoc. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Nansy GJERAZI

Rafael HOXHA

**FORMULA E LLOGARITJES SË PIKËVE TË KONKURSIT TË PRANIMIT NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE PËR VITIN AKADEMIK 2016-2017**

- 1. P** Pikët e përgjithshme të nevojshme për rankim **140 Totali.**
- 2. NMP** Nota mesatare e përgjithshme sipas VKM nr. 407, ose 30% e barabartë me **42 pikë.**
- 3. PK** Pikët e konkursit të pranimi ose 70% e barabartë me **98 pikë.**

Formula e llogaritjes së pikëve

$$P = (NMP/10 \times 0.3 + PK/98 \times 0.7) \times 140$$